

TREGUESIT FINANCIAR

TRE-MUJORI I PARË 2025



INFORMACION CILËSOR

Informacion permbledhes mbi metodën standarte për vlerësimin e mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës:

Tirana Bank, bazuar në rregulloren për "Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit" përllogarit mjaftueshmërinë e kapitalit si raport ndërmjet shumës së kapitalit rregullator me shumën e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun. Për secilin prej zërave të ekspozimeve të bankës, në bazë të rrezikut që ato kanë, bëhet llogaritja e kërkesës për kapital për rrezikun e kredisë së kundërpartisë, rrezikun e tregut dhe atë operacional. Vlerësimi i kërkesës për kapital për rrezikun e kredisë dhe të kundërpartisë llogaritet sipas metodës standarte të përcaktuar në këtë rregullore. Banka përdor Metodën Standarte për të llogaritur kërkesën për kapital për rrezikun operacional. Kërkesa për kapital për rrezikun e tregut që vjen si rezultat i rrezikut të kursit të këmbimit, llogaritet nga Banka nëse pozicioni i hapur valutator për periudhën raportuese (cdo 6 muaj) është më shumë se 2% e kapitalit rregullator.

Ekspozimet e ponderuara me rrezikun llogariten si shumë e :

- a) Aseteve të ponderuara me rrezikun për rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë (zërat e bilancit të ponderuara me rrezik dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezikun mbas aplikimit të faktorit të konvertimit të kredisë).
- b) Kërkesës për kapital për rrezikun e tregut shumëzuar me 12.5.
- c) Kërkesës për kapital për rrezikun operacional shumëzuar me 12.5.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për Tirana Bank në fund të tremujorit të parë të vitit 2025 është në nivelin 17.7%.



INFORMACION SASIOR

Zërat e ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme të ponderuara me rrezikun e kredisë sipas Metodës Standarte

Nr.	Zerat e ekspozimeve dhe te ekspozimeve te mundshme te ponderuara me rrezikun e kredisë	Tremujori I'2024	Tremujori II'2024	Tremujori III'2024	Tremujori IV'2024	Tremujori I'2025
		Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë
1	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore	2,500,598,180	2,271,529,909	2,955,243,491	3,818,487,330	4,290,614,702
2	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale	-	1,253,633,393	1,297,113,128	59,054,518	-
3	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jo tregtare (organizatat joqeveritare/jofitimprurëse)	1,470,156,701	1,027,534,389	965,371,861	1,917,619,227	2,064,643,044
4	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare	-	-	-	-	-
5	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura	9,560,950,750	6,101,410,613	4,724,627,284	4,502,365,867	5,092,477,227
6	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave)	29,782,288,277	34,683,579,683	34,354,226,333	37,632,949,952	38,525,729,937
7	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail)	9,805,208,278	10,662,548,462	11,857,503,416	12,160,684,438	13,206,489,980
8	Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme	6,870,266,364	7,319,795,821	7,635,351,963	7,767,090,112	8,350,560,691
9	Ekspozime (kredi) me probleme	674,570,029	638,444,737	649,776,129	558,796,745	591,264,255
10	Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë	4,965,828,265	5,451,288,920	6,959,737,338	6,975,744,459	7,655,414,577
11	Zëra të tjerë	1,534,589,089	1,590,560,395	1,495,928,044	1,680,324,018	1,666,993,365
	Total	67,164,455,933	71,000,326,320	72,894,878,985	77,073,116,667	81,444,187,777



INFORMACION SASIOR

2 Kërkesa për kapital për rrezikun e tregut , sipas kërkesave të përcaktuara në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, të shumëzuara me 12.5 :

	Tremujori I'2024	Tremujori II'2024	Tremujori III'2024	Tremujori IV'2024	Tremujori I'2025
	Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë
Kerkesat për kapital për rrezikun e tregut					
a) Kërkesa për kapital për aktivitetin në librin e tregtueshëm*	-	-	-	-	-
a.1) Rreziku i pozicionit	-	-	-	-	-
a.2) Rreziku i përqendrimit	-	-	-	-	-
b) Kërkesa për kapital për të gjitha pozicionet e bankës	-	-	-	-	-
b.1) Rreziku i shlyerjes	-	-	-	-	-
b.2) Rreziku i pozicioneve në mallra	-	-	-	-	-
b.3) Rreziku i kursit të kembimit	-	-	-	-	-
Kerkesa per kapital per rrezikun e tregut te shumezuar me 12.5	-	-	-	-	-

*Tirana Bank nuk ka pozicione në instrumenta financiare dhe në mallra të mbajtura me qëllim tregtimin e tyre.

3 Kërkesa për kapital për rrezikun operacional, e llogaritur sipas metodës standarte, të përcaktuar në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, të shumëzuar me 12.5

	Tremujori I'2024	Tremujori II'2024	Tremujori III'2024	Tremujori IV'2024	Tremujori I'2025
	Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë
Kerkesa per kapital per rrezikun operacional	665,848,509	665,848,509	665,848,509	828,671,617	828,671,617
Kerkesa per kapital per rrezikun operacional e shumezuar me 12.5	8,323,106,361	8,323,106,361	8,323,106,361	10,358,395,212	10,358,395,212

4 Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit

Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit	Tremujori II'2015	Tremujori I'2024	Tremujori II'2024	Tremujori III'2024	Tremujori IV'2024	Tremujori I'2025
1.Kapitali rregullator	8,691,021,193	12,798,772,593	13,588,497,588	15,203,987,006	15,086,143,158	16,280,942,310
2.Totali i aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezikun	40,897,415,152	75,487,562,294	79,323,432,680	81,217,985,346	87,431,511,879	91,802,582,990
3.Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit* (1/2)*100	21.25	17.0	17.1	18.7	17.3	17.7



INFORMACION CILËSOR

Informacion permbledhes mbi rrezikun e kredise:

Tirana Bank konsideron Kredi me Probleme kreditë e klasifikuara në tre kategoritë e fundit të klasifikimit të kredive. Shuma bruto (kryegjë + interes) e tyre përbën totalin e kredive me probleme. Tirana Bank klasifikon kredite e saj ne klasat e meposhtme ne perputhje me rregulloren e Bankes se Shqiperise “Per administrimin e rrezikut te kredise nga bankat dhe deget e bankave te huaja”.

1. Kredi standarde
2. Kredi ne ndjekje
3. Kredi nenstandarde
4. Kredi te dyshimta
5. Kredi te humbura

Tre kategorite e fundit (konkretisht kredite nenstandarde, te dyshimta dhe te humbura) perbejne edhe kredite e klasifikuara me probleme. Kredite e klasifikuara ne dy klasat e para perbejne kredite e rregullta.

Provigjonimi i kredive behet ne perputhje me kriteret e rregullores “Per administrimin e rrezikut te kredise nga bankat dhe deget e bankave te huaja” si ne drejtim te kriterëve per provigjonim, ashtu edhe ne drejtim te normave te provigjonimit.

Tirana Bank synon ruatjen e nje profili prudent te rrezikut, duke i dhene prioritet: a) ruajtjes se nje baze te forte kapitali, (b) ruajtjes se nje baze te diversifikuar te burimeve te financimit, (c) perforcimit te bilancit te saj, (d) ruajtjes se cilesise se asetëve dhe diversifikimin e portofolit te kredise dhe (e) manaxhimin efektiv te shpenzimeve operacionale.

Ne drejtim te rrezikut te kredise:

'=> Banka synon te kontrolloje rrezikun e kredise nepermjet kriterëve te kujdesshme te kredidhenies. Procesi mbeshtetet nga perdorimi i sistemeve te brendshme te vleresimit me aftesidiskriminim te sistemeve per matjen e rrezikut te kredise dhe perlllogaritjen e kerkesave per kapital.

=> Banka fokusohet ne rritjen e portofolit te kredise ne sektoret me pritshmeri me te mira zhvillimi.

=> Banka synon reduktimin e detyrimeve ne vonese nepermjet identifikimit te rrezikut te kredise, monitorimit te vazhdueshme dhe masava kundervepruese.

=> Banka synon administrimin me efektivitet te niveleve te kredive me probleme, duke reduktuar ritmet e krijimit te kredive te reja me probleme dhe ulur nivelin e tyre.

=> Banka synon monitorimin direkt dhe te qenderzuar te te gjitha ekspozimeve te kredise ne nivel kredimarresi dhe palesh te lidhura.

=> Banka operon brenda limiteve te kredise te percaktuara dhe aprovuara nga Bordi i Drejtoreve, te cilat rishikohen ne menyre te rregullt dhe mbulojne te gjitha aktivitetet e bankes qe mbart kredie.



INFORMACION CILËSOR

1. Emrat e institucioneve të jashtëm të vlerësimit të kredisë (ECAI) dhe agjencive të kreditimit të eksporteve (ECA), si dhe arsyet e çdo ndryshimi;

Tirana Bank përdor (kur kjo është e aplikueshme) vlerësimet e kredisë të lëshuara nga Standard & Poor's, Moody's dhe Fitch, të njohura nga Banka e Shqipërisë si agjensi të pranuar të vlerësimit të kredisë.

2. Klasat e ekspozimit për të cilën është përdorur institucioni i jashtëm i vlerësimit të kredisë (ECAI) dhe agjencia e kreditimit të eksporteve (ECA)

Vlerësimet e kredisë nga institucionet e jashtme të vlerësimit të kredisë përdoren për:

- a) Ekspozimet ndaj qeverive qendrore
- b) Ekspozimet ndaj institucioneve të mbikëqyrura
- c) Ekspozimet ndaj shoqërive tregtare

kurdo që një vlerësim i tillë ekziston apo nuk mbivendoset nga rregulla të tjera të paracaktuara të rregullores "Per Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit".



INFORMACION PËR PORTOFOLIN E KREDISË SIPAS METODËS STANDARTE

INFORMACION SASIOR

Vlerat e ekspozimeve sipas cilësisë së kredisë, para dhe pas aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë

Nr.	Zerat e ekspozimeve dhe te ekspozimeve te mundshme	Tremujori I' 2024		Tremujori II' 2024		Tremujori III' 2024		Tremujori IV' 2024		Tremujori I' 2025	
		Vlera e ekspozimit (para aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë*) (në Lekë)	Vlera e ekspozimit (pas aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë**) (në Lekë)	Vlera e ekspozimit (para aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë*) (në Lekë)	Vlera e ekspozimit (pas aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë**) (në Lekë)	Vlera e ekspozimit (para aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë*) (në Lekë)	Vlera e ekspozimit (pas aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë**) (në Lekë)	Vlera e ekspozimit (para aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë*) (në Lekë)	Vlera e ekspozimit (pas aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë**) (në Lekë)	Vlera e ekspozimit (para aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë*) (në Lekë)	Vlera e ekspozimit (pas aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë**) (në Lekë)
1	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore	52,806,340,494	52,806,340,494	54,683,360,626	54,683,360,626	61,134,883,222	61,134,883,222	68,684,476,257	68,684,476,257	64,870,372,532	64,870,372,532
2	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale	-	-	3,253,131,057	3,253,131,057	3,300,537,631	3,300,537,631	295,272,592	295,272,592	-	-
3	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jo tregtare (organizatat joqeveritare/jofitimprurëse)	1,427,915,696	1,427,915,696	1,111,637,261	1,045,583,699	1,051,908,737	986,869,549	4,204,762,253	3,731,707,685	4,113,377,817	3,899,281,678
4	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare	-	-	-	-	-	-	-	-	993,146,177	993,146,177
5	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura	19,720,336,612	17,690,226,086	15,595,215,651	13,179,589,486	14,026,270,403	11,809,091,624	13,002,816,807	10,602,827,664	17,400,121,487	14,915,978,792
6	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave)	36,987,552,810	34,140,558,750	41,018,039,067	40,426,153,643	40,645,393,767	40,084,235,173	43,802,411,332	37,983,065,321	46,606,238,783	38,817,536,214
7	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail)	13,532,494,571	13,133,099,139	14,634,814,363	14,305,649,253	16,639,357,155	16,187,419,580	17,500,347,682	15,716,653,709	19,275,616,501	17,218,370,211
8	Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme	14,640,224,273	14,640,224,273	15,216,381,587	15,216,381,587	15,382,679,804	15,382,679,804	15,281,406,796	14,957,962,250	16,878,395,525	16,092,222,265
9	Ekspozime (kredi) me probleme (pas zbritjes se fondeve rezerve)	670,328,028	663,889,968	634,714,823	628,436,986	637,273,857	631,064,507	551,598,140	551,533,132	574,258,414	574,258,414
10	Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë	3,270,691,597	3,253,094,887	3,600,687,125	3,583,472,672	4,654,778,421	4,591,263,656	4,655,728,046	4,584,693,752	5,064,553,551	4,992,175,093
11	Zëra të tjerë	3,389,134,551	3,389,134,551	3,483,394,492	3,483,394,492	4,247,632,072	4,247,632,072	4,200,691,945	4,200,691,945	3,350,757,256	3,350,757,256
Total		146,445,018,633	141,144,483,846	153,231,376,052	149,805,153,501	161,720,715,069	158,355,676,817	172,179,511,850	161,308,884,307	179,126,838,042	165,724,098,633

* Duke përfshirë vlerat e zerave jashtë bilancit para aplikimit të faktoreve të konvertimit.

** Tirana Bank përdor për qëllime të zbutjes së rrezikut të kredise kolateralin financiar.

INFORMACION SASIOR

2.Ekspozimet e zbritshme nga kapitali rregullator

Nr.	Ekspozimet e zbritshme nga kapitali rregullator	Tremujori I'2024	Tremujori II'2024	Tremujori III'2024	Tremujori IV'2024	Tremujori I'2025
		Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë
	Ekspozime të zbritshme nga kapitali rregullator	0	0	0	0	0
	Total	0	0	0	0	0



INFORMACION CILËSOR

1. Informacion përmbledhës mbi teknikat e zbutjes së rrezikut të kredisë:

Tirana Bank përdor si teknikë të zbutjes së rrezikut të kredisë "Mbrojtjen e Financuar të Kredisë" e bazuar në përdorimin e Kolateralit Financiar, dhe përdor për këtë qëllim Metoden Gjithëpërfshirëse të Kolateralit Financiar.

Kolaterale të tjera si kolaterale rezidenciale dhe ato komerciale përdoren gjithashtu gjerazi në procesin e kredidhënies, duke reduktuar rrezikun që rrjedh nga ekspozimet e kredisë. Për qëllime të përdorimit të tyre si teknika të zbutjes së rrezikut (në drejtim të aplikimit të faktorëve të reduktuar të rrezikut), kolaterale të natyrës rezidenciale, vlerësohen të paktën një herë në tre vjet nëpërmjet metodave statistikore të ngritura nga Banka dhe të pranueshme nga kuadri rregullator në fuqi.

Kolaterale të natyrës komerciale vlerësohen çdo vit, gjatë procesit të rishikimit të dosjes së kredisë.

INFORMACION SASIOR

2. Vlera e ekspozimit total (neto) pas netimit/kompensimit në bilanc dhe jashtë bilancit (nëse është e aplikueshme), në rastin e përdorimit të mbrojtjes së financuar të kredisë dhe garancise:

	Tremujori I' 2024	Tremujori II' 2024	Tremujori III' 2024	Tremujori IV' 2024	Tremujori I' 2025
	Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë
Ekspozimi origjinal - zërat brenda dhe jashtë bilancit - përpara aplikimit të kolateralit financiar dhe garancive	146,445,018,633	153,231,376,052	161,720,715,069	172,179,511,850	179,126,838,042
Kolaterali Financiar	5,300,534,787	3,426,222,550	3,365,038,251	10,870,627,543	13,402,739,409
Garanci					
Ekspozimi (neto) - zërat brenda dhe jashtë bilancit - pas aplikimit të kolateralit financiar dhe garancive	141,144,483,846	149,805,153,501	158,355,676,817	161,308,884,307	165,724,098,633



TABELA 9: RREZIKU I KREDISË SË KUNDËRPARTISË (ÇDO TREMUJOR)

INFORMACION CILËSOR

Informacion përmbledhës mbi derivativët dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë :

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2025, Tirana Bank nuk ka përlogaritur kërkesë për kapital për rrezikun e kredisë së kundërpartisë si pasojë e mungesës së ekspozimeve në librin e bankës dhe librin e tregtueshëm të tilla si:

- 1.Instrumentet derivative mbi banak;
- 2.Derivatvët e kredisë;
- 3.Marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes së letrave me vlerë (me përjashtim të transaksioneve të tilla me Bankën e Shqiperisë të cilat nuk kerkojnë kapital) dhe të mallrave, transaksionet e huadhënies dhe huamarrjes së letrave me vlerë dhe të mallrave;
- 4.Transaksionet e huadhënies me marzhe të letrave me vlerë;
- 5.Transaksionet me afat të gjatë shlyerje.

TITULLZIMI

INFORMACION CILËSOR

Tirana Bank nuk ka ekspozime te titullzuara.



INFORMACION CILËSOR

Informacion përmbledhes cilësor, për rreziqet e tregut sipas kërkesave të rregullores "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit"

Tirana Bank llogarit kërkesen për kapital për rrezikun e tregut si shumë të:

a) kërkesës për kapital për aktivitetin në librin e tregtueshëm e cila përfshin:

i. kërkesën për kapital për rreziqet e pozicionit;

ii. kërkesën për kapital për rrezikun e përqendrimit;

*Banka llogarit kërkesën për kapital për aktivitetin në librin e tregtueshëm, siç specifikohet në rregulloren për "Mjaftueshmërine e Kapitalit", në rast se plotësohen kushtet e mëposhtme:

- gjatë dy gjashtëmujorëve të fundit, raporti i vlerës mesatare kontabël të librit të tregtueshëm ndaj totalit të aktivitetit nuk është më i lartë se 5%. Në asnjë kohë ky raport nuk është më i lartë se 6%;

- gjatë dy gjashtëmujorëve të fundit, vlera mesatare kontabël e librit të tregtueshëm nuk është më e lartë se 15 milionë euro. Në asnjë kohë kjo vlerë nuk është më e lartë se 20 milionë euro.

b) kërkesën për kapital për të gjitha pozicionet e bankës (pozicione në librin e tregtueshëm dhe pozicione në librin e bankës) e cila përfshin:

i. kërkesën për kapital për rrezikun e kursit të këmbimit

ii. kërkesën për kapital për rrezikun e shlyerjes

iii. Kërkesën për kapital për rrezikun e pozicioneve në mallra

Tirana Bank nuk ka në portofolin e saj të letrave me vlerë tituj të tregtueshëm, rrjedhimisht nuk llogarit kërkesë për kapital për aktivitetin në librin e tregtueshëm. Gjithashtu, ajo nuk ka në fund të tremujorit të parë të vitit 2025 pozicione në mallra dhe transaksione me rrezik të shlyerjes duke mos llogaritur kërkesë për kapital për këtë portofol.

Tirana Bank kryen monitorim të vazhdueshëm të rrezikut ndaj normes së interesit dhe kursit të këmbimit, duke ruajtur nivelet e këtyre të fundit brenda limiteve të kuadrit rregullativ dhe limiteve të saj të brendshme.



INFORMACION SASIOR

Gjatë tremujorit të trete të vitit 2024 kërkesa për kapital për rrezikun e tregut është në nivelin 0 milione Leke, si rezultat i pozicionit të hapur valutor në Qershor 2024 < 2% e kapitalit rregullator të bankes.

	Tremujori IV' 2023	Tremujori I' 2024	Tremujoril II' 2024	Tremujoril III' 2024	Tremujoril IV' 2024	Tremujoril I' 2025
	Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë
Kerkesa per kapital per rrezikun e tregut	-	-	-	-	-	-
Kerkesa per kapital per rrezikun e tregut e shumezuar me 12.5	-	-	-	-	-	-



INFORMACION CILËSOR

Informacion përmbledhës për metodën e përdorur në vlerësimin e rrezikut operacional (Metoda Standarte)

Tirana Bank përdor metodën standarte për të përllogaritur kërkesën për kapital për rrezikun operacional. Sipas kësaj metode, aktiviteti i bankës ndahet në 8 linja biznesi dhe banka përllogarit të ardhurat neto për cdo linje biznesi për tre vitet e fundit.

- a) Kërkesa për kapital për cdo linjë biznesi përllogaritet duke shumezuar të ardhurat neto në një vit të dhënë me një koeficient Beta që varion nga 12%-18% (sipas përcaktimeve të rregullores).
- b) Nëse rezultatit i llogaritur (në pikën a) për një vit është negativ, atëherë vlera për vitin përkates konsiderohet 0 (zero).
- c) Kërkesa për kapital e bankës është mesatarja e tre viteve të fundit e shumatores së rezultatit të llogaritur në pikën a.

Për tremujorin e parë të vitit 2025, kërkesa për kapital për Rrezikun Operacional është vlerësuar në nivelin 828.7 milion lekë. Përllogaritja e kërkesës për kapital për Rrezikun Operacional kryhet cdo 1-vit në përputhje me rregulloren për "Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit".

INFORMACION SASIOR

Kërkesa për kapital për rrezikun operacional, e llogaritur sipas metodës standarte, të përcaktuar në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, të shumëzuar me 12.5

	Tremujori I' 2024	Tremujori II' 2024	Tremujori III' 2024	Tremujori IV' 2024	Tremujori I' 2025
	Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë	Vlerat ne Lekë
Kerkesa per kapital per rrezikun operacional	665,848,509	665,848,509	665,848,509	828,671,617	828,671,617
Kerkesa per kapital per rrezikun operacional e shumezuar me 12.5	8,323,106,361	8,323,106,361	8,323,106,361	10,358,395,212	10,358,395,212



EKSPozIMET NË INSTRUMENTAT E KAPITALIT: INFORMACION MBI POZICIONET E PËRFSHIRA NË LIBRIN E BANKËS

INFORMACION CILËSOR

Informacion përmbledhës lidhur me investimet në aksione të përfshira në librin e bankës

Tirana Bank nuk zotëron në portofolin e saj tituj kapitali gjatë tremujorit të parë të vitit 2025.

RREZIKU I NORMËS SË INTERESIT NË LIBRIN E BANKËS

INFORMACION CILËSOR

Informacion përmbledhës mbi ekspozimet ndaj rrezikut të normës së interesit në pozicionet në librin e bankës:

Tirana Bank kryen monitorim të vazhdueshëm të rrezikut ndaj normës së interesit, duke ruajtur nivelet e treguesve të matur për këtë qëllim brenda limiteve të kuadrit rregullativ dhe limiteve të saj të brendshme. Banka mat rrezikun e normave të interesit bazuar në udhëzimin nr. 33 date 30.04.2013 "Mbi administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës" nëpërmjet metodës së vlerësimit të ndryshimit në ekspozimin e librit të bankës duke supozuar një goditje (shock) prej +200 pikësh bazë në kurbën referencë të kthimit. Efekti që rezulton në ekspozimin e librit të bankës krahasohet kundrejt kapitalit rregullator. Ky raport nuk duhet të jetë më shumë se 20%.



RREZIKU I NORMËS SË INTERESIT NË LIBRIN E BANKËS

INFORMACION SASIOR

Banka përllëgarit raportin për administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës me frekuencë 3 mujore.

Treguesi i rrezikut të normës së interesit në librin e bankës ndaj kapitalit rregullator	Periudha	Mars 2024	Qershor 2024	Shtator 2024	Dhjetor 2024	Mars 2025
	Niveli	4.82%	7.84%	6.21%	8.54%	9.85%
	Limit rregullativ	20%	20%	20%	20%	20%

Forma totale e IRRBB-s	Totali i pozicioneve të ponderuara	
IRR	Monedha	Shuma (në lekë)
1.1 Pozicionet e ponderuara neto sipas monedhes- (FIR+VIR)	LEK	1,729,985,188
1.2 Pozicionet e ponderuara neto sipas monedhes - (FIR+VIR)	EUR	(49,849,057)
1.3 Pozicionet e ponderuara neto sipas monedhes - (FIR+VIR)	USD	(59,295,873)
1.4 Pozicionet e ponderuara neto sipas monedhes - (FIR+VIR)	TE TJERA	(17,510,747)
2. Ndryshimi në vlerën e ekspozimit		1,603,329,511
3.Kapitali rregullator		16,280,942,310
4.(Ndryshimi në vlerën e ekspozimit / Kapitalin rregullator) *100		9.85%



INFORMACION CILËSOR

Tirana Bank në përputhje me rregulloren nr.71, datë 14.10.2009 "Per administrimin e rrezikut te likuiditetit", ndryshuar me vendim nr. 75, datë 26.10.2011 dhe ndryshuar me vendim nr. 28, datë 27.03.2013 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë si dhe të politikës së brendshme mbi administrimin e rrezikut te likuiditetit, ka krijuar nje strukturë organizative të përshtatshme për administrimin e këtij rreziku, duke percaktuar qartë kompetencat dhe ndarjen e përgjegjësive të njësive/funksioneve organizative të bankës që realizojnë monitorimin dhe administrimin e tij. Tirana Bank administron dhe mat rrezikun e likuiditetit duke u fokusuar në kriteret e mëposhtme:

- i. Parashikimin e flukseve hyrëse dhe flukseve dalëse të cash-it (Liquidity Gap);
- ii. Krahasimin e afatit të maturimit të fondeve dhe të burimeve të financimit;
- iii. Përqendrimin e depozitave dhe burimeve të tjera të financimit sipas maturiteteve, llojit dhe strukturës së klientelës;
- iv. Pozicionit aktual të likuiditetit duke përfshirë vlerësimin e gjendjes së aktiveve likuide dhe të kolateraleve;
- v. Nivelin e luhatshmërisë së depozitave;
- vi. Matjen e treguesve të likuiditetit dhe monitorimin e tyre ditor ne funksion te administrimit të likuiditetit në bankë;
- vii. Kryerjen e stress test-it te likuiditetit si element të monitorimit të këtij rreziku.

Totali i depozitave të Tirana Bank vlerësohet në fund të tremujorit të parë të vitit 2025 në nivelin 1'304 milion euro kundrejt 1'267 milion euro llogaritur në fund të tremujorit të katërt të vitit 2024. Depozitat me afat, gjatë tremujorit të parë të vitit 2025 përbëjnë 58.45% të totalit të depozitave, duke shënuar një rritje të peshës krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2024 ku ky tregues ishte ne nivelin 57.4%. Përberja e depozitave me afat sipas monedhave kryesore për tremujorin e parë të vitit 2025 është 45.6% të depozitave me afat në monedhën vendase (leke), 49.15% në euro dhe 4.67% në usd.

Tirana Bank kryen monitorime ditore të rrezikut të likuiditetit nëpërmjet strukturave të saj në Divizionin e Thesarit dhe Tregjeve Financiare, Financës dhe Administrimit të Rrezikut.



RREZIKU I LIKUIDITETIT

Treguesit e likuiditetit tregojnë për një situatë të qëndrueshme të Tirana Bank. Treguesit rregullativë qëndrojnë në fund të tremujorit të parë të vitit 2025 brenda limiteve rregullative. Përqëndrimi i depozitave vlerësohet të jetë relativisht i ulët si pasojë e bazës tejet të diversifikuar të depozituesve. Monitorimi i shokut të rrezikut të likuiditetit si dhe gap-eve të likuiditetit (vlerësuar sipas flukseve të pritshme), tregojnë për nivele të këtyre treguesve brenda politikës së bankës.

	Mars 2024	Qershor 2024	Shtator 2024	Dhjetor 2024	Mars 2025	Limiti rregullativ
Treguesit baze te rrezikut te likuiditetit						
Kredi / Depozita	58%	63%	63%	63%	65%	NA
Kredi neto / Depozita	56%	61%	61%	61%	62%	NA
LCR ne total	205%	211%	200%	202%	200%	100%
LCR ne monedha te huaja te rendesishme	111%	130%	149%	156%	125%	80%



BILANCI





Tirana Bank vijon të ketë rezultate shumë të mira financiare, të jetë e mirëkapitalizuar, me një likuiditet të lartë dhe të rritet në mënyrë të qëndrueshme edhe për tremujorin e parë të vitit 2025. Në sajë të kontributit të të gjitha linjave të biznesit, fitimi neto i Bankës në 31 Mars 2025 mbetet në nivele të larta.

Në fund të tremujorit të parë të 2025, totali i aktiveve ka shënuar sërish një rritje prej 3.3% (5.3 miliardë lekë) nga Dhjetori i vitit të shkuar, duke arritur vlerën e rreth 164.86 miliardë lekëve. Rritja në totalin e aktiveve vijon t'i atribuohet kryesisht rritjes së depozitave të klientëve.

Portofoli i kredise mesatarisht në terma bruto njohu një rritje prej 7% në tremujorin e parë të 2025. Në Mars 2025 kredia përbën rreth 50% të totalit të aktiveve të Bankës.

Banka ka përmirësuar ndjeshëm raportin e huave të saj jo-performuese (NPL-ve) gjatë viteve të fundit, duke arritur në nivelin 2.9% në Mars 2025 dhe po ndërton një portofol të performancës, nga pikëpamja cilësore, në përputhje me kushtet mbizotëruese të tregut. Raporti i kredive me probleme (2.9%) mbetet ndër më të ulëtit në treg krahasuar me raportin prej 4.06% të sistemit bankar (Shkurt '25), duke tejkaluar ndjeshëm raportin e NPL-ve në tregun vendas.

Për sa i përket depozitave të klientëve, kemi patur një rritje prej 4.03% në ALL, ndërsa USD dhe EUR paraqitet në nivele konstante në tremujorin e parë të 2025. Përafërsisht 70% e depozitave të klientëve janë nga klientet individë, që tregojnë për një bazë shumë të larmishme financimi. Banka ka arritur të rrisë burimin e saj kryesor të financimit gjatë tremujorit të parë të 2025 me kosto të optimizuara.

Gjatë tremujorit të parë të 2025, të ardhurat neto nga interesi janë më të larta krahasuar me tremujorin e katërt të 2024. Rritja nga të ardhurat neto nga interesi me rreth 4.85%, vjen kryesisht nga rritja e portofolit të kredise, rritja e të ardhurave nga investimet në letrat me vlerë. Shpenzimet nga interesat janë rritur krahasimisht me vitin e kaluar, si rrjedhojë e rritjes së portofolit të depozitave nga klientet dhe rritjes së normave të interesit.

Të ardhurat neto nga komisionet deri në muajin Mars janë të larta, pothuajse sa e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Në përgjithësi, të gjitha llojet e komisioneve janë më të larta krahasuar me vitin e kaluar duke përfshirë komisionet e kartave, tarifave të disburseimit, transfertave të parave dhe tarifave të arkëtimit, duke mbetur mbi shifrat e buxhetuara.

Tremujori i parë i vitit 2025 vijon të tregojë në përgjithësi, përmirësim të marzheve të përfitueshmërisë së Bankës, duke reflektuar rritjen e treguesve të biznesit dhe kostot e optimizuara të financimit. Raporti kosto/të ardhura është në nivelin 46.8% në muajin Mars 2025.

Treguesit e tjere kryesore, mbeten në nivele të larta. Kështu, treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit në Mars 2025 rezulton të jetë 17.73%. Banka vazhdon të mbetet me tregues të lartë Likuiditeti dhe rentabiliteti, tregues të qartë të mirë funksionimit të saj.

Një ecure e tillë pozitive, pritët edhe në vijim, duke treguar stabilitet dhe përforcuar me tej pozicionin e Bankës në tregun bankar, pavarësisht sfidave të reja dhe situatave aktuale globale.

ç fa rë d o t ë a r r i s h s o t ?

BILANCI

Aktivet	31-Mar-25	31-Dec-24
Veprimet e Thesarit & Nderbankare	30,987,852	35,065,061
Arka dhe Banka Qendrore	11,697,052	14,266,671
Bono Thesari	4,174,089	8,601,743
Llogari ne banka & Institucione Financiare	1,390,480	508,399
Depozita me Banka	8,544,963	6,579,361
Hua per Banka dhe Institucione Financiare	5,181,268	5,108,886
Veprime me Klientet	76,910,270	71,596,222
Hua standarde	75,027,677	69,954,571
Hua te papaguara ne afat	194,409	106,169
Hua ne ndjekje	1,031,795	901,281
Hua nen standard	866,002	507,982
- fonde rezerve	(272,493)	(122,069)
Hua te dyshimta	126,356	497,157
- fonde rezerve	(63,476)	(248,869)
Hua te humbura	1,451,654	1,438,344
- fonde rezerve	(1,451,654)	(1,438,344)
Veprime me Letrat me vlere	54,997,136	50,919,931
Mjete dhe detyrime te tjera	1,217,310	1,258,974
Mjete te perhershme (neto)	743,656	696,797
Totali i aktiveve	164,856,224	159,536,986

Pasivet	31-Mar-25	31-Dec-24
Veprime e Thesarit & Nderbankare	21,634,745	22,055,733
Llogari rrjedhese me Banken Qendrore dhe Bono Thesari	11,483,255	15,627,189
Llogari me Banka & Institucione Financiare	1,730,817	784,206
Depozita nga Banka & Institucione Financiare	8,420,673	5,644,338
Veprime me Klientet	121,209,425	117,062,295
Qeveria Shqiptare & Administrata publike	4,327,533	4,620,787
Detyrime ndaj klienteve per llogarite rrjedhese	43,676,219	43,898,442
Detyrime ndaj klienteve per llogarite pa afat	2,540,606	2,452,578
